



REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIKA E KOSOVËS
QEVERIA E KOSOVËS - VLADE KOSOVA
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTRI OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
Arbëri Qendror - Centralno Arhivo - Centralni Arhiv

Nr./Nr./No. 1721/2
Nr. i Sq./Sr. Ser./No. 2+2
Data/Datum/Date: 06.05.2022
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti Ligjor/Pravni Departament/ Legal Department

HYRESE - ULAZNA - INCOMING
REPUBLIKA KOSOVË/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/VLADE KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Loka i Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

06.05.2022

Nr. i Dokumentit	Nr. i Lendës	Vlera
41	453-580/2	

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës së Glllogocit Milaïm Hadri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme, MAPL Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Kujtim Aliu, Zyrtar i Lartë Ligjor	
Përmes:	Faton Peci, Ministër i MBPZHR-së Blerim Hasani, Sekretari i Përgjithshëm i MBPZHR-së	
Nga:	Isah Rudaku, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, MBPZHR	Date: 06.05.2022 Ref. 10.91/2022
Zyrtarët përgjegjës:	Isah Rudaku, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, MBPZHR	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor		
Lënda:	Përgjigje në Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	Rregullore Nr.400/01-18380 për ndarjen e Subvencioneve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit	

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave më datë 29.04.2022, ka pranuar nga MAPL, Rregulloren Nr.400/01-18380 për ndarjen e Subvencioneve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, me datën 27.04.2022 si dhe i parashtruar për shqyrtim në MAPL, me datën 28.04.2022.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, bënë:

Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit

Rregullore Nr.400/01-18380 për ndarjen e Subvencioneve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit i miratuar më datë: 27.04.2022.
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 28.04.2022

Kërkesa për ndarjen e subvencioneve e propozuar me Rregulloren Nr.400/01-18380 për ndarjen e Subvencioneve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit më datë: 27.04.2022, është në pajtim me Nenin 12 paragrafi 12.2 pika (c) dhe nenit 40 (40.2) pika (a) dhe (c) të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr.28/04 Qershor 2008), citohet:

12.2. "Aktet e kuvendit të komunës vlejnë në territorin e komunës që ka miratuar aktin. Këto akte përfshijnë: c) rregulloret komunale";

40.2 "Kuvendi i komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për: a) statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre, c) miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës";

Nenin 17 paragrafi 17.2, dhe nenin 38 paragrafi 1 Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare Nr.27/03.06.2008), citohet:

17.1 "Paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike. Asnjë autoritet publik, organizatë buxhetore, person apo ndërmarrje nuk mund të devijojnë, keq zbatojnë, ekspozojnë apo të përdorin në mënyrë të pa rregullt paratë publike".

17.2 "Shpenzimi i parave publike mund të bëhet vetëm nga fondet e ndara dhe të alokuara dhe vetëm në përputhje me procesin i cili është themeluar nga Rregullat KMF sipas paragrafit 2 të nenit 38 të këtij ligji".

38.1 "Nuk do të lejohen kurrfarë mjetesha nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për bërjen e pagesave kur nuk ekziston një njoftim aktual për alokimin e fondeve me anë të të cilit autorizohet përdorimi i të hollave për bërjen e pagesave të tilla".

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt,



QEVERIA E KOSOVES - Qeveria e Kosovës
MINISTRIA E BUEKESISE, PYLLTARISE DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
Balkan Candidate - Kandidat Ballkan - Kandidat Ballkan

Nr./Br./No. 1721/2
Nr. llog./Br. Sr. No. pg. 2+2
Data/Date/Data: 06.05.2022
PRISTINE PRISTINE PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti Ligjor/Pravni Departament/ Legal Departament

Za:	Ramiz Lladrovci, Gradonačelnik opštine- Glogovac Milaim Hadri, Predsednik Skupštine opštine - Glogovac	
Kopija:	Elbert Krasniqi, Ministar MALU Venera Çerkini, Zm. Generalni sekretar MALU Besim Murtezani, Zm. Rukovodilac Pravnog Departmana i Monitoring Opština Xhevat Tafa, Zm. Rukovodilac Divizije za Monitoring Opština, Kujtim Aliu, visi pravni službenik	
Preko:	Faton Peci, Ministar MPŠRR-a Blerim Hasani, Generalni Sekretar MPŠRR-a	
Od:	Isah Rudaku, Zm. Direktora Pravnog Departmana, MPŠRR	Datum: 06.05.2022 Ref. 10.91/2022
Odgovorni službenici: 1. Službenik za pravnu procenu potvrde 2. Službenik za pravnu procenu	Isah Rudaku, Zm. Direktora Pravnog Departmana, MPŠRR	
Predmet:	Odgovor na Zahtev za preispitivanje zakonitosti akta Opštine Glogovac	
Vrsta akta:	Uredba br. 400 / 01-18380 o dodeli subvencija odobrenih od strane Skupštine opštine Glogovac	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

Ministarstvo poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja, u skladu sa Uredbom (VRK) br. 06/2021 o izmenama i dopunama Uredbe (VRK) br. 10/2019 o administrativnoj reviziji opštinskih akata dana 29.04.2022, primio je od MALS Uredbu br. 400 / 01-18380 o dodeli subvencija odobrenih od Skupština opštine Glogovac, dana 27.04.2022. godine i dostavljena na razmatranje MALS-u, dana 28.04.2022.

Ministarstvo poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja, nakon razmatranja zakonitosti predmetnog akta, u skladu sa članom 4. Uredbe (VRK) br. 06/2021 o izmenama i dopunama Uredbe (VRK) br. 10/2019 za administrativno razmatranje opštinskih akata, donosi:

Razmatranje zakonitosti Akta

Uredba br. 400/01-18380 o dodeli subvencija odobrena od strane Skupštine opštine Glogovac usvojena: datuma 27.04.2022.

Dostavljeno na razmatranje MALU datuma: 28.04.2022

Zahtev za dodelu subvencija predložen Uredbom br. 400/01-18380 za dodelu subvencija odobren od strane Skupštine opštine Glogovac dana: 27.04.2022, u skladu je sa članom 12 stav 12.2 tačka (c) i članom 40 (40.2.) tačka (a) i (c) Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi (Službeni list br. 28/04. juna 2008. godine), citira se:

12.2. "Aktovi Skupštine opštine važe na teritoriji opštine koja je usvojila akt. Ovi akti uključuju: c) opštinske propise";

40.2 "Skupština opštine ne delegira svoje nadležnosti u vezi sa donošenjem odluka za: a) statut i poslovnik rada, opštinski propis i njihovo usvajanje, izmenu i njihovo ukidanje, c) usvajanje drugih finansijskih pitanja koja su rezervisana za skupštinu prema statutu ili poslovniku rada";

Član 17 stav 17.2 i član 38 stav 1 Zakona br. 03/L-048 o upravljanju javnim finansijama i odgovornosti (Službeni list br. 27/03.06.2008), citira se:

17.1 "Javni novac će se koristiti samo za odobrene javne svrhe. Nijedan javni organ, budžetska organizacija, lice ili preduzeće ne može da odstupa, zloupotrebljavaju, izlože ili zloupotrebljavaju javni novac".

17.2 Potrošnja javnog novca može se vršiti samo iz dodeljenih i raspodeljenih fondova-sredstava i samo u skladu sa procesom utvrđenim Pravilima kontrole finansijskog upravljanja -KFU-a prema stavu 2 člana 38 ovog zakona."

38.1 "Neće biti dozvoljena nikakvih sredstva iz Konsolidovanog budžeta Kosova za isplate kada ne postoji trenutno obaveštenje o raspodeli sredstava koje ovlašćuje korišćenje novca za vršenje takvih isplata".

Ministarstvo poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja, nakon razmatranja sadržaja opštinskog akta kao što je gore navedeno, ocenjuje da opštinski akt je u skladu sa odredbama važećeg zakona.

Ministarstvo poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja ostaje na raspolaganju opštini i MALS-u za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.

S poštovanjem,



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
KUVENDI I KOMUNËS

Nr. 01-40061-18380 . dt. 27. 04. 2022



Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, nenin 17 pika 1, 2 nenit 38 pika 1 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenit 34. pika 34.6 të Statutit të Komunës së Glllogocit, të datës 16.09.2008, në bazë të vendimit më 01-Nr. 020-2805, të datës 19.01.2022, Kuvendi i Komunës së Drenasit/Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë **27. 04. 2022**, miraton këtë:

RREGULLORE

PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË RREGULLORES PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE

Neni 1

Duke u bazuar në dispozitat ligjore të lartëcekura në parhyrje të këtij propozimi për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve, propozohet ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores me nr.320-19338, të datës 07.04.2017 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së Subvencioneve.

Neni 2

Te neni 5 tek rregullat e përgjithshme të aplikimit për subvencione ndryshohet paragrafi 4 i nenit 5.

Neni 3

Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave për ndarjen e subvencioneve jashtë thirrjes publike të shpallur nga komuna bëhet 30 ditë kalendarike nga parashtrimi i kërkesës.

Neni 4

Te neni 8 tek: vlerësimi i kërkesave dhe vendimarrja ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 9 i nenit 8.

Neni 5
Kryetari merri vendim për ndarjen e subvencioneve, në përputhje me rekomandimin e komisionit, ndërsa parashtrimi i ankesës bëhet sipas neni 10 paragrafi 1 të rregullorës në fuqi.

Neni 6
Te neni 10 tek: parashtrimi dhe zgjidhja e ankesave, ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 2 i neni 10.

Neni 7
Komisioni i ankesave vendos mbi ankesën brenda pesë (5) ditësh nga dita e pranimit të saj.

Neni 8 **Subvencionet për Arsium**

Të neni 14 të subvencionet për arsim, paragrafi 1 ndryshohet dhe plotësohet, nenparagrafi 1.1, i shtohet pika 1.1.1, ndryshohet dhe plotësohet nenparagrafi 1.2, i shtohet pika 1.2.1, nenparagrafi 1.3, i shtohet pika 1.3.1, 1.3.2, nenparagrafi 1.4 hiqet, zëvendësohet me nenparagrafin në renditje me 1.4 (shih nenparagrafi 1.5), i shtohet pika 1.4.1, nenparagrafi 1.6 hiqet, zëvendësohet me nenparagrafin në renditje me 1.5 (shih nenparagrafi 1.6), i shtohet pika 1.5.1 deri në 1.5.9, nenparagrafi 1.7 hiqet, zëvendësohet me nenparagrafin në renditje me 1.6 (shih nenparagrafi 1.7), i shtohet pika 1.6.1 deri në 1.6.7, dhe neni 14 paragrafi 2 ndryshohet dhe plotësohet.

Neni 9

1. Komuna mund të ndajë subvencione për arsim duke përfshirë, ndryshuar dhe plotësuar disa kritere, për:
 - 1.1. Bursa për student;
 - 1.1.1. Studentë të regullt të Universiteteve Publike në Kosovë prej vitit të I (parë) deri në vitin e VI (gjashtë) të studimeve.
 - 1.2. Bursa për nxënës në shkollë të mesme të lartë;
 - 1.2.1. Nxënës/a më i dalluar në Komunë për vitin përkatës, shpërblim në shumën prej 300 €,
 - 1.3. Bursa për nxënës në shkolla fillore;
 - 1.3.1. Nxënës/a më i dalluar në Komunë për vitin përkatës, prej klasës 1 deri 5, shpërblim në shumën prej 100 €
 - 1.3.2. Nxënës/a më i dalluar në Komunë për vitin përkatës, prej klasës 6 deri 9, shpërblim në shumën prej 200 €
 - 1.4. nxënësit me nevoja të veçanta;
 - 1.4.1. Ti ndahet një shumë mujore prej 50 €, për dhjetë (10) muaj gjatë vitit shkollor, prej klasës 1 deri 12.
 - 1.5. nxënësit që kanë treguar rezultate në nivel ndërkombëtar, kombëtar, komunal, në kuize dhe gara të diturisë;
 - 1.5.1. Vendi i parë në nivel ndërkombëtar, shpërblim në shumën prej 1.000 €,
 - 1.5.2. Vendi i dytë në nivel ndërkombëtar, shpërblim në shumën prej 900 €,
 - 1.5.3. Vendi i tretë në nivel ndërkombëtar, shpërblim në shumën prej 800 €,
 - 1.5.4. Vendi i parë në nivel kombëtar, shpërblim në shumën prej 500 €,

- 1.5.5. Vendi i dytë në nivel kombëtar, shpërblim në shumën prej 400 €,
- 1.5.6. Vendi i tretë në nivel kombëtar, shpërblim në shumën prej 300 €,
- 1.5.7. Vendi i parë në nivel komunal, shpërblim në shumën prej 300 €,
- 1.5.8. Vendi i dytë në nivel komunal, shpërblim në shumën prej 200 €,
- 1.5.9. Vendi i tretë në nivel komunal, shpërblim në shumën prej 100 €,
- 1.6. mësimdhënësit që kanë treguar rezultate në nivel ndërkombëtar, kombëtar, komunal në kuize dhe gara të diturisë;
- 1.6.1. Vendi i parë në nivel ndërkombëtar, shpërblim në shumën prej 2.000 €
- 1.6.2. Vendi i dytë në nivel ndërkombëtar, shpërblim në shumën prej 1.500 €
- 1.6.3. Vendi i tretë në nivel ndërkombëtar, shpërblim në shumën prej 1.000 €
- 1.6.4. Vendi i parë në nivel kombëtar, shpërblim në shumën prej 500 €
- 1.6.5. Vendi i dytë në nivel kombëtar, shpërblim në shumën prej 400 €
- 1.6.6. Vendi i tretë në nivel kombëtar, shpërblim në shumën prej 300 €
- 1.6.7. Mësimdhënësi/e me i dalluar në nivel komunal, shpërblim në shumën prej 400 €
2. Kryetari i Komunës me vendim të veçantë e cakton numrin e përfutjesve të studentëve për bursë komunale dhe shumën e subvencionimit, ndërsa kategoritë e përfutjesve të bursave do të përcaktohen më këtë ndryshim plotësues rregullor.

Neni 10

Të neni 15 të kriteret dhe dokumentet që nevojiten për ndarjen e bursave, tek paragrafi 1 ndryshohet dhe plotësohet, nënparagrafi 1.1, i shtohet pika 1.1.1, deri me 1.1.7, ndryshohet dhe plotësohet nënparagrafi 1.2, i shtohet pika 1.2.1, plotësohet dhe ndryshohet nënparagrafi 1.3, i shtohet pika 1.3.1, 1.3.2, 1.3.3, nënparagrafi 1.4 hiqet, zëvendësohet me nënparagrafin në renditje me 1.4 (shih nënparagrafi 1.4), i shtohet pika 1.4.1, nënparagrafi 1.5 hiqet, zëvendësohet me nënparagrafin në renditje me 1.5 (shih nënparagrafi 1.5), i shtohet pika 1.5.1 dhe 1.5.2, nënparagrafi 1.6, i shtohet pika 1.6.1, shtohet pika 2.

Neni 11

Kriteret dhe dokumentet që nevojiten për ndarjen e bursave

Përcaktohen kriteret dhe dokumenta të garta më këtë propozim rregullor për dhënien e bursave, duke përfshirë :
Notën mesatare;

Prej 6 deri 7	-	5 pikë
Prej 7.01 deri 8	-	10 pikë
Prej 8.01 deri 9	-	20 pikë
Prej 9.01 deri 9.50	-	30 pikë
Prej 9.51 deri 10	-	40 pikë
Me deftesën shumë mirë	-	30 pikë
Me deftesën shkëlqyeshëm	-	40 pikë

Numri i studentëve në familje;

Student që ka edhe ndonjë anëtar tjetër të familjes së ngushtë në studime (motër, vëlla, prind, fëmijë). Anëtar tjetër mund të jetë edhe në nivel tjetër të studimeve (Master ose Doktoratë), për çdo student/e shtesë – 5 pikë.
Kategoritë e dala nga lufta ;

Student – fëmijë i dëshmorit të luftës së UÇK-së - 10 pikë
Student – fëmijë i invalidit të luftës së UÇK-së - 5 pikë,
Student – fëmijë i veteranit të luftës së UÇK-së - 5 pikë.

Student që studiojnë në drejtimet deficiare;

Student të drejtimeve deficiare (për çdo vit akademik do te merret një shkresë zyrtare ne Rektoratin e Universitetit të Prishtinës për drejtmet deficiare) – 5 pikë.

Kategoritë tjera;

Student bonjak (pa të dy prindërit) - 10 – pikë,
Student me nevoja të veçanta - 10 – pikë.

Gjendja ekonomike;

Student nga familja me ndihmë sociale - 10 – pikë.
Studentët me pikë të barabarta në rënditjen përfundimtare do të rënditen me notën mesatare më të lartë, nëse notat mesatare janë të njëjta do të shkohen në bazë të rënditjes alfabetike.

Neni 12

Neni 15 nënparagrafi 2. ndryshohet dhe plotësohet, nënparagrafi 2.1. i shtohet pika 2.1.1, nënparagrafi 2.2., i shtohet pika 2.2.1, ndryshohet dhe plotësohet nënparagrafi 2.3. i shtohet pika 2.3.1, nënparagrafi 2.4. i shtohet pika 2.4.1, nënparagrafi 2.5. i shtohet pika 2.5.1, nënparagrafi 2.6. i shtohet pika 2.6.1, ndryshohet dhe plotësohet nënparagrafi 2.7. i shtohet pika 2.7.1 dhe neni 3 i shtohet pika 3.1.

Neni 13

Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të bursave përfshijnë :

1. Dokumentat e kërkuara për të aplikuar për bursë komunale për vitin përkatës të studimeve;

1.1. Dokumenti i identifikimit;

1.1.1. Kopja e letërnjoftimit dhe e karteles se studentit.

Certifikata e notave;

Certifikata e notave të studimeve (kandidatët që janë në vitin e parë të studimeve Bachelor dhe që nuk kanë nota në studime duhet të sjellin dëshmi nga fakulteti që ende nuk kanë nota dhe duhet të sjellin Certifikatën e notave të klasës së fundit të shkollës së mesme të lartë.

Vërtetimi që është student në universitetin publik dhe të mos jetë përsëritës;

Vërtetimi nga universiteti publik (fakulteti apo departamenti përkatës) se kandidati është student i rregullt në nivelin e studimeve Bachelor në vitin përkatës të studimeve, duke specifikuar fakultetin/drejtimin e studimeve, që kandidati e ka të regjistruar vitin akademik dhe që kandidati nuk ka përsëritur (humbur) ndonjë vit akademik.

Certifikatë e vendbanimit;

Vërtetimi i nxjerrur në Zyrën e Gjendjes Civile që e dëshmon vendbanimin (original apo e noterizuar)

Dëshmia mbi gjendjen ekonomike;

Vërtetimi i nxjerrur në Qëndren për Punë Sociale (original).

Dëshmia se prindërit janë kategori të dala nga lufta;

Vërtetimi i nxjerrur nga Shogatat e dalura nga lufta (original).

Dëshmi që student/e nuk është në marrdhënie të punës;

Pasqyra e llogarisë nga Trusti pensional në tre mujorin e fundit.

Aplikuesi nuk mund të jetë përfitues bursës nëse brenda vitit njëjtë fiskal ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga pushteti qendror ose ndonjë donatorë tjetër për fushën e njëjtë;

Vërtetim se nuk është përfitues i bursës studentore për vitin akademik përkatës, si dhe ti dërgohet lista e përfituesve të bursës komunale në Rektoratit e Universitetit të Prishtinës (në mënyrë që të mos jenë përfitues i bursës komunale dhe universitare për vitin përkatës të studimeve).

Subvencionet për Zhvillim Ekonomik

Neni 14

Te neni 16 tek Subvencionet për zhvillim ekonomik, hiqet nënparagrafi 1.2, 1.9, plotësohet nënparagrafi 1.4 i neni 18, plotësohet nënparagrafi 1.7 i neni 18 dhe plotësohet nënparagrafi 1.8 i neni 18 (shih nënparagrafet prej 1.1 deri në 1.3 në rënditje).

Neni 15

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione për zhvillim ekonomik

Çertifikata e biznesit (Për bizneset egzistuese, taksën në biznes),
Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (Bizneset egzistuese),
Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit (Biznesit).

Neni 16

Subvencionet për Bujqësi

Te neni 19 paragrafi 1, shtohen nënparagrafet më emërtime të reja prej 1.5 deri në 1.13 (shif nëparagrafet prej 1.1 deri 1.9 në rënditje), te neni 19 paragrafi 2, ndryshohet dhe plotësohet nënparagrafi 2.2 deri 2.4, shtohet nënparagrafi 2.5 deri në 2.7 (shih nënparagrafet prej 2.1 deri 2.7 në rënditje), shtohet paragrafi 3, te neni 20 pika 2 për subvencionet në bujqësi, ndryshohet dhe plotësohet nënparagrafi 2.2, hiqet nënparagrafi 2.3, zëvendësohet më nënparagrafin tjetër 2.3, hiqet nënparagrafi 2.4, zëvendësohet më nënparagrafin tjetër 2.4, ndryshohet dhe plotësohet nënparagrafi 2.6, shtohet nënparagrafi 2.7 (shih nënparagrafet prej 1.1 deri 1.7 në rënditje).

Neni 17

Komuna mund të ndajë subvencione për bujqësi, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
Ndarjen e paisjeve dhe mekanizmit bujqësor;
Ngritjen e serrave;
Projekteve në fushën e pemëtarisë dhe perimtarisë;
Projekteve në fushën e bletarisë;
Projekteve në fushën e blegtorisë;

Projekteve në fushën e lavëtarisë;
Projekteve në zhvillim rural;
Mbështetjen e projekteve me bashkëfinancim;
Projekteve në sektorin e pylltarisë.

Gjatë ndarjes të subvencioneve për bujqësi, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi:

Pjesëmarrjes së fermerit në bashkëfinancim (10-30% të vlerës totale të projektit) në përfshirje kur në thirrjen publike është përcaktuar ndryshe;

Grave, të rinjve, personave që kanë anëtar të familjes me nevojë të veçanta dhe atyre me status të veçantë (familjet e dëshmorëve, familjet që kanë persona të zhdukur gjatë luftës së fundit, invalidët e luftës, viktimat civile të luftës);

Aplikuesit/familjarët e ngushtë që nuk kanë fituar në tre vitet e fundit subvencione nga komuna (Aplikuesit/familjarët e ngushtë të cilët kanë përfutur në vitin fiskal largohen automatikisht nga përfutimi) si dhe aplikuesit të cilët gjatë vitit të njejtë fiskal nuk kanë qenë përfutur në një subvencion për bujqësi, të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër;

Projektet e personave, OJQ-ve, etj, që kanë siguruar bashkëfinancim nga palët e treta, sipas vlerës jo më pak se 40 % të vlerës totale të projektit;

Projektet që gjenerojnë vende të reja pune.

Gjendja ekonomike (dëshmi);

Zonave me prioritet nga komuna.

Komuna përmes drejtorisë përkatëse, çdo fillim vitë duhet të organizojë takime publike me palët e interesuara për të shpjeguar detajet e thirrjeve publike për atë vit dhe përmes këtyre takimeve shpjegohen kushtet, kriteret e aplikimit.

Neni 18

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione në bujqësi për persona fizik

Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarjen të subvencioneve të cilat ndikojnë në zhvillimin e bujqësisë duhet të jenë (duke mos u kufizuar):

Numri identifikues i fermerit (NIF);

Projekti ideor i aplikuesit (i marrë në drejtorinë gjegjëse);

Dokumenti identifikues (letënjohimi);

Certifikata familjare (për persona fizikë);

Dëshmi për pagesën e tatimit në prone;

Dëshmi për bashkëfinancim (nëse ka bashkëfinancim) merret në Drejtorinë përkatëse;

Dëshmi për pronën e paluajtshme (fletëposeduese) dhe nese kerkohet nga drejtoria edhe kopjen e planit.

Neni 19

Subvencionet për Shëndetësi dhe Mirëqenjen Sociale

Te neni 21 tek Subvencionet për shëndetësi dhe mirëqenjen sociale ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 1, paragrafi 2, hiqet nënparagrafi 2.3 dhe 2.4, plotësohet nënparagrafi 2.6 (shih nënparagrafi 2.1 në rënditje), plotësohet nënparagrafi 3.4 (shih nënparagrafi 3.1 në rënditje), ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 4, shtohet nënparagrafi 4.1 dhe 4.6, ndërsa ndryshohen dhe plotësohen nënparagrafi prej 4.2,4.3,4.4,4.5.

Neni 20

Komuna subvencionon në formë të përkrahjes financiare banorët residentë të Komunës së Drenasit, për përballimin e shpenzimeve të shërimin nga sëmundjet e rënda, rehabilitimit, për rastet emergjente shëndetësore, për familjet që janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale, sipas kriterëve të përcaktuara në paragrafin 2 të neni 21 të rregullorës. Kriteret që duhet të plotësohen për të qenë përfshues i ndihmës materiale-financiare janë: mirëqenja sociale- gjendja e rëndë ekonomike familjare.

Gjatë ndarjes së subvencioneve në shëndetësi, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi rasteve specifike si në vijim:

Gjendja ekonomike familjare (me asistencë sociale);

Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për shëndetësi për personat fizik përfshijnë, duke mos u kufizuar:

Formulari i kërkesës/aplikacioni

Dokument identifikimi (Letërnjoftimi (kopje) për të rriturit, Ekstrakt i lindjes për të miturit)

Dokumentacioni mjekësor që konstaton diagnozën e mjekut specialist

Konfirmimi bankar i llogarisë së aplikuesit ose nga personi kujdestar ligjor

Dëshminë mbi shpenzimet e mjekimit (kupon fiskal / faturë apo profaturë)

Dëshmia mbi gjendjen ekonomike-sociale.

Neni 21

Subvencionet për Kulturë, Rini dhe Sport

Te neni 22 tek Subvencionet për kulturë, rini, sport, te paragrafi 1, shtohet nënparagrafi 1.16. (shih nënparagrafi 1.1 në rënditje), nënparagrafi 3.1 ndryshohet dhe plotësohet (shih nënparagrafi 2.1 në rënditje), nënparagrafi 3.2 ndryshohet dhe plotësohet (shih nënparagrafi 2.2 në rënditje), nënparagrafi 3.4 plotësohet (shih nënparagrafi 2.3 në rënditje), hiqet nënparagrafi 3.6, zëvendësohet më nënparagrafin në rënditje të ndryshuar dhe plotësuar (shih nënparagrafi 2.4 në rënditje), plotësohet nënparagrafi 3.7 (shih

nënparagrafi 2.5 në rënditje), shtohet paragrafi 3, ndryshohet dhe plotësohet nënparagrafi 3.8 (shih nënparagrafi 3.1 në rënditje), shtohet nënparagrafi 3.10 (shih nënparagrafi 3.2 në rënditje), shtohet nënparagrafi 3.11 (shih nënparagrafi 3.3 në rënditje) dhe te neni 23 ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 4 (shih paragrafi 1 në rënditje).

Neni 22

Komuna mund të ndajë subvencione për kulturë, rini dhe sport duke e plotësuar edhe në;

Manifestime, shënimi i datave historike, shënimi i festave kombtare dhe ndërkombetare dhe shënimi i datave me rëndësi në Komunën e Drenasit.

2. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencione;
 - 2.1. Aplikacioni (Formulari për përshkrimin e projektit/programi në CD);
 - 2.2. Formulari i buxhetit i plotësuar;
 - 2.3. Çertifikata e vendbanimit (për personat fizik e juridik);
 - 2.4. Çertifikatën e numrit fiskal të OJQ-së;
 - 2.5. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (për personat fizik e juridik);
3. Dokumentacioni obligativ për përfutjesit e përzgjedhur të subvencioneve;
 - 3.1. Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për personat juridik jo ma e vjeter se 3 muaj);
 - 3.2. Dëshmi se nuk është nën hetime për veprë penale (jo ma e vjetër se 3 muaj)
 - 3.3. Konkursesit me rastin e aplikimit të paragesin kopjen e raportit Narrativ dhe Financiar të nënshkruar nga menaxheri i projektit të DKRS-së (nëse janë përfutjes të subvencioneve nga Komuna në vitin paraprak);

Neni 23

Raportet kthyes nga përfutjesit e Subvencioneve

Periodha kohore e raportimit duhet të jetë 30 ditë pas përfundimit të projektit për ata që përfitojnë jashtë thirrjes publike dhe 20 Janari pas përfundimit të vitit fiskal për ata që kanë përfutuar në thirrje publike, të specifikohet në marrëveshje në mes palës përfutuese dhe Komunës apo me vendimin e Kryetarit të Komunës.

Neni 24

Subvencionimi i O.JQ-ve

Të gjithë personat juridik të regjistruar në Ministrinë e Administratës Publike dhe statusi i regjistrimit të tyre është Organizatë joqeveritare (OJQ), për përfutimin e subvencioneve, i nënshtrohen parimeve dhe predispozitave të përgjithshme të Rregullores MF—NR.04 / 2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Proeedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, e cila është në fuqi.

A r s y e t i m

Të subvencionet për Arsim, tek neni 14 (shih më lartë prej nenit 3 nënparagrafi 1.1 deri 1.6.7) janë paraparë si shpërblim bursa për studentë prej vitit të parë deri në vitin e gjashtë, nxënësit të shkollës fillore, te mesme të ulët dhe të mesëm të lartë, nxënësit me nevoja të veganta, për nxënësit që nxënë vendin e parë, dytë dhe tretë në kuize dhe gara të diturisë në nivel ndërkombëtar, kombëtar, komunal, pastaj për mësimdhënësit që nxënë vendin e parë, dytë dhe tretë në kuize dhe gara të diturisë në nivel ndërkombëtar, kombëtar dhe për mësimdhënësin më të dalluar gjatë një viti shkollor përkatës.

Të neni 15 të kriteret dhe dokumentet që nevojiten për ndarjen e bursave (shih më lartë prej nenit 5 paragrafi 1 dhe 2) janë paraparë 100 pikë në total (më përjashtim kur një student/e aplikues ka më shumë së një student/e në familje, mund të shkoj mbi totalin e lartëcekur), prej tyre sa i përket notes mesatare deri në 40 pikë dhe posedimin e dukumentacionit tjetër deri në 60 pikë, ku dukumentacioni përfitshet tek numri i studentëve në familje, kategoritë e dala nga lufta, student që studiojnë në drejtimet deficitare, kategoritë tjera dhe gjëndja ekonomike.

Ne neni 5 paragrafi 2 si më lartë është paraparë zgjidhja kur mund të vij situata: psh; i kemi 160 përfutës të bursës komunale, para numrit 160 dhe pas tij mund të renditën studentët me pike të barabarta dhe si zgjidhje vien në shprehje kriteri nota me e lartë mesatare apo edhe më note të njëjtë mesatare vien kriteri renditja alfabetike.

Të neni 15 (shih më lartë neni 7) tek dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të bursave, kërkohen vërtetima, certifikata, dëshmi tjera për ta vërtetuar se ato dukumenta a janë valide për ti poenizuar si me lartë.

Te subvencionet për Zhvillim Ekonomik, në neni 16 pika 1.2 Aksesor- mëndojm që janë në pikën 1.1, pika 1.3 agrobizneset janë të parapara në DBZHR ndersa pika 1.9 inkubatorët e biznesit tani me kanë mbetur në të kaluarën, andaj mendojmë nuk është e domesdoshme që të përfshihen në subvencione.

Ne neni 18 pika 1.5 mendojmë se nuk ka nevojë të jetë si dëshmi pagesa e taksave komunale kur dihet që ka lloje të ndryshme të taksave

Te subvencionet për Bujqësi, tek neni 19 i Rregullores për subvencionim, nuk janë të përfshira as një fushë e projekteve bujqësore e specifikuara për përkrahjen e fermerëve për këtë arsye ne si komision i kemi bërë plotësimin e fushave të ndryshme bujqësore ne mënyrë që te jetë rregullorja me e përshatshme per detajet e thirrjes publike për subvencionimin e fermerëve dhe përmes këtyre takimeve shpjegohen fushat kushtet dhe kriteret e aplikimit.

Të subvencionet për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, tek neni 21, plotësohet paragrafi 1, paragrafi 2, hiqet nënparagrafi 2.3 dhe 2.4, i neni 21, plotësohet nënparagrafi 2.6, plotësohet nënparagrafi 3.4, ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 4 i nenit 21, mendojmë

se këto ndryshime të propozuara nga drejtoria kanë qenë të nevojshme dhe do ta lehtësojnë punën e organit kompetent për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për subvencionim, po ashtu krijon lehtësira edhe për palën e interesuar për aplikim për ndarje të subvencioneve.

Te subvencionet për Kulturë, Rini dhe Sport, tek neni 22 paragrafi 1 (shih si më lartë neni 15 nënparagrafi 1.1) i Rregullores për Subvencione i dt. 07.04.2017 është shtuar ngase është i nevojshëm që aktivitei i vlerave të UÇK-së të përfshihet në këtë propozim ndryshim të Rregullores dhe ka mungu si pozicion në Rregulloren Komunale për Subvencione.

Paragrafi 3.6 i neni 22 (shih si më lartë neni 15 paragrafi 2) është hjekur ngase më shumë krijon pengesa gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve.

Paragrafi 3.10 i neni 22 (shih si më lartë neni 15 nënparagrafi 3.2) është shtuar ngase nuk mund të jetë përfutës i subvencionit një person fizik që është nën hetime për vepër penale.

Paragrafi 3.11 i neni 22 (shih si më lartë neni 15 nënparagrafi 3.3) është shtuar ngase secili përfutës i Subvencioneve Komunale duhet t'i arsyetoj mjetet e shpenzuara me raport të vlerësuar nga menaxheri i projektit.

Te neni 22 pika 3 janë paraparë disa dokumentacione obligative (shih si më lartë neni 15 paragrafi 3) për përfutësit e përzgjedhur të subvencioneve ngase janë esenciale në përzgjedhjen e përfutësit të subvencioneve, duke mos i përfshijtur dokumentacionet tjera (shih si më lartë neni 15 paragrafi 2) që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve.

Paragrafi 4 i neni 23 (shih si më lartë neni 16 paragrafi 1) është ndryshuar dhe plotësuar ngase secili raport i përfutësit duhet të jetë i arsyeshëm për shpenzimin e bërë dhe të ketë datën përcaktuese të mbylljes së shpenzimit.

Neni 25

Ky Vendim për ndryshim dhe plotësim i Rregullores për subvencione, hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

